




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.rks-gov.net/gjilan, tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

Duke u bazuar në nenin 38, paragrafi 1.2 dhe 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, në harmoni me Planin Detal Urbanistik "Qarku", me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Kadastër dhe Rindërtim të dt. 21.10.2011, për dhënen e pëlqimit për këmbimin e pronave private me pronë komunale me qëllim të ndërtimit të rrugës publike sipas PDU, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 06.04.2012, miraton këtë :

V E N D I M

Për dhënen e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Zona "Qarku" Gjilan.

I.

Me këtë Vendim, Komuna e Gjilanit **Jep pëlqimin për këmbimin** e pjesës së pronave të paluajtshme private me një pjesë të pronave të paluajtshme komunale të cilat gjinden te vendi i quajtur "Museljaqke Njive / Arat e Muslive", Zona Kadastrale Gjilan, sipas propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me qëllim të ndërtimit të rrugës publike sipas zgjidhjes urbanistike të paraparë me Planin Detal Urbanistik "Qarku" në Gjilan, i miratuar në Kuvendin Komunal me dt. 04.10.2002 me Vendimin nr. 01-8030/020.

II.

Për implementimin e zgjidhjes urbanistike të cekur në pikën I të këtij Vendimi është e nevojshme të bëhet ky këmbim: **Zyrafete Korça** nga Gjilani, si pronare e ngastrës kadastrale P-70403013-00574-3 me sipërfaqe prej 251 m², duhet t'i japë Komunës së Gjilanit një pjesë të kësaj ngastre me sipërfaqe prej 77.98 m². **Xhevat Selimi**, nga Gjilani, si pronarë i ngastrës kadastrale P-70403013-00574-2 me sipërfaqe prej 334 m² duhet t'i japë Zyrafete Korçës një pjesë të kësaj ngastre me sipërfaqe prej 65,10 m². **Komuna e Gjilanit** si pronare e ngastrës kadastrale P-70403013-01871-0, me sipërfaqe prej 16552 m² e jep një pjesë të kësaj ngastre me sipërfaqe prej 81.27 m² dhe atë : sipërfaqen prej 12.28 m² ja jep Zyrafete Korçës, kurse sipërfaqen prej 68.99 m² ja jepë Xhevat Selimit.

III.

Autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që para se të lidhen marrëveshjet për këmbim ta bënë parcelimin e ngastrave kadastrale të cekura në pikën II të këtij Vendimi e të cilat janë objekt i këmbimit.

VI.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Nr. 01_16-38274

Gjilan, më 06.04.2012

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues